



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 28.6.2013, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kasumi, Musli Mehaj, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Valon Hiseni, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Shefki Gashi, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefqet Sylejmani, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Lumnie Rama, Astrit Hasani, Mejreme Berisha, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mehdiu, Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu.

Munguan: Liridon Restelica, Besa Halimi - Zagragja, Meliza Haradinaj, Fetah Salihu dhe Engin Beyoglu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE - së, të mjeteve të informimit dhe përfaqësuesit e kompanisë projektuese "Hidroing - DK".

Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Sadri Ramabaja tha se është krijuar shprehi që në fund të seancës po mbesim shumë pak, sidomos kur po vjen çështja e diskutimeve të çështjeve të ngritura etj. Prandaj, duket se, dhe jo pa qëllim, është përmbys ky rend i ditës, krahasuar me nivelet tjera të kuvendeve. Kam tri çështje, për të cilat do të doja që të shprehem konkretisht. Për çështjen e nivelit të cilësisë në arsimin tonë parauniversitar, që do të ishte mirë që të futej ose në këtë rend të ditës sot, ose në një mbledhje të ardhshme, për të cilën kemi folur sa e sa herë. Për çështjen e mungesës së transparencës dhe për këtë do të propozoja konkretisht që ekstrakti, respektivisht procesverbali, ndoshta do të ishte më mirë ekstrakti, të publikohej në ueb-faqen e Komunës. Dhe çështja e tretë është e karakterit teknik, por që shpjegon shumë gjendjen e organizimit tonë, që ka të bëjë me mirëmbajtjen e oborreve të ambulancave. Nëse e shihni të arsyeshme që t'i fusim në rend të ditës, nëse jo, atëherë unë do t'i shtroj në pikën "të ndryshme".

Lidhur me çështjen rreth cilësisë së arsimit, **kryesuesi** tha se kur të merren të gjitha rezultatet, kjo çështje do të jetë në rend dite për shqyrtim, ndërsa për çështjet e tjera mund të ngrihen për diskutim në pikën "të ndryshme".

U konstatua se njëzëri u miratua ky

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë;
2. Propozimvendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor urban për periudhën 2013-2022;
3. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ambasadës gjermane;
4. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim SHPI - KFOR-it, "Film City";
5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik;
6. Propozimi për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim;
7. Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore;
8. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013;
9. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor urban për periudhën 2013-2022, Kryesuesi tha se është obligim që rrjedh nga Ligji për planifikim dhe ndërtim, pra Komuna duhet t'i miratojë dy plane fundamentale, që janë: Plani zhvillimor komunal dhe Plani zhvillimor urban.

Dukagjin Hasimja përfaqësues i Kompanisë "Hidroing - DK", në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij plani, duke elaboruar disa nga komponentet më kryesore të tij. Pas prezantimit nga përfaqësuesi i kompanisë, **Kryesuesi** hapi diskutimin.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se shumë nga ne këtu kemi marrë pjesë në takime punuese për këtë Plan zhvillimor urban. Në të gjitha këto takime, por edhe në KPF, janë dhënë vërejtje dhe sugjerime që në masë të madhe janë marrë parasysh. Vërejtjet që janë dhënë në KPF e që nuk janë marrë parasysh, si dhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që mund të dalin nga ky Kuvend këtu, por edhe gjatë debatit që do të mbahet 30 ditë, sa është i paraparë, të merren parasysh, të përgatiten për versionin final të këtij projektplanit zhvillimor urban.

Ne si GP i LDK-së e përkrahim dhe i japim lejen që të dërgohet në debat publik.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se nga ajo që na u prezantua, vërehet se në pjesën urbane të qytetit do të hyjnë edhe disa fshatra të Gollakut. Kisha bërë pyetje pse ka hyrë ajo vijë prerëse dhe e ka ndarë fshatin Mramor nga pjesa urbane, ndërsa një pjesë tjetër të fshatrave e fut në zonën urbane. Sa i përket hekurudhës ekzistuese, ajo nuk është funksionale, vërehet se në kohën e fundit kërkohet që të funksionalizohet. Kisha kërkoi ta dijë se si do të funksionalizohet qarkullimi i asaj pjese të hekurudhës, pra pjesës së vjetër të qytetit, që nisat prej stacionit të Prishtinës e deri te tuneli, pa rrezikim të qytetarëve ?

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, fillimisht i përshëndeti përfaqësuesit e kompanisë dhe i përgëzoi për gjithë angazhimin dhe punën që e kanë bërë deri këtu. Lidhur me planin tha se si shqetësim që e kam ngritur, ka qenë mos koordinimi i punës në mes Këshillit të ekspertëve, që është në kuadër të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, i cili është miratuar dhe asnjë informacion nuk po vjen prej tyre. Pra, kishte me qenë mirë që të ketë një transparencë më të madhe në këtë drejtim. Është e pa justifikueshme që Komiteti për planifikim të mos mbajë një takim, një mbledhje, kur kemi të bëjmë me dy planet më jetike që e determinojnë zhvillimin e komunës së Prishtinës.

Ky plan është dashur që të bazohet shumë edhe në hulumtimin e opinionit përmes anketave, ku do të hetoheshin aspiratat, dëshirat e qytetarëve të komunës së Prishtinës, për arsye se planifikimi bëhet për interesin e qytetarit. Njëherësh kompania do të duhej që pak a shumë t'i bënte disa analiza, për të mos u mbështetur ndoshta në të dhëna, të cilat nganjëherë krijohet përshtypja se janë edhe hipotetike, si p.sh. tash jemi në lajthitje të çështjet e regjistrimit etj.

Nuk kemi një përgjigje rreth ndërtimeve pa leje, të cilat përfshijnë mbi 50% të sipërfaqes së rajonit ekzistues ndërtimor dhe nuk jepet ndonjë alternativë e mundshme se cila kishte me qenë forma e tejkalimit ose të zgjidhjes së tyre, apo njëra prej atyre formave. Këtij plani i mungon analiza e kostos së realizimit, i mungon identifikimi i forcave shtyese pak a shumë për implementimin e objektivave të parashtruara etj.

Po ashtu nuk është bërë një zbrëthim i duhur kur është bërë ndarja e distrikteve të Prishtinës. Pra, në bazë të cilave parametra apo hulumtimeve janë bërë këto?

Ndoshta kishte me qenë mirë që pak a shumë të jenë të specifikuara projektet për synimin e zhvillimit të Komunës në aspektin urban. Megjithatë, ky plan ka doli shumë më i mirë sesa Plani zhvillimor komunal.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se pasi ky plan do të jetë në diskutim publik, si GP pajtohem që të ecim përpara.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se e përgëzojmë kompaninë për këtë punë që e ka bërë. Më bëri përshtypje shpërprurja e popullsisë, regjistrimi i qytetarëve të Prishtinës nuk është real. Parametrat që u përmendën këtu besoj që do t'i vejnë një theks edhe më të veçantë, se kishte njëfarë mekanizmi në bazë të orëve të rrymës që u përmendën, por mund të ketë edhe mekanizma të tjerë, për të treguar që në Prishtinë ka më shumë popullatë sesa ai regjistrim që doli se kjo qenka e lidhur mandej me zhvillimin, buxhetin, financat dhe të tjerat.

Në këtë plan është dashur që të parashihet edhe ndonjë rrugë e çiklistëve dhe motoçiklistëve, të shihet mundësia se ku mund të bëhet ajo. Gjithashtu u prezantuan objektet arsimore, çerdhet etj., por me objektet kulturore është mirë që të shkojnë edhe

objektet fetare. Po të ishte bërë ndonjë anketë me qytetarë, ndoshta do të mund t'i ndihmonte që t'i kenë parasysh edhe ato objekte. Njëherësh kërkoi të dijë se si janë parametrat në rajon për një çerdhe, dhe për Prishtinën çka parashihet.

Me plotësime dhe sugjerime edhe ne i japim vizën këtij plani për diskutim publik.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), i përshëndeti ekspertët që e prezantuan Planin zhvillimor urban të Prishtinës 2013-2022.

Ky plan megjithatë vjen me disa vite vonesë dhe është përgjegjësi e udhëheqësve të Komunës, e që kjo vonesë natyrisht e ka edhe koston e vetë, prandaj qyteti sot është kështu si është në përmasa të mëdha, tërësisht i degraduar, dhe se ky plan do të jetë vështirë të realizohet për arsye se është peng i segmenteve të inkriminuara të shoqërisë sonë. Komiteti për planifikim i Komunës pothuajse është inekzistent. Ky komitet në vend që të na i prezantonte vërejtjet e Komunës etj. etj. nuk funksionon.

Debati publik për këtë plan kaq të rëndësishëm urban po mbetet tutje tejet formal. Do të dëshironim që tonin këtij debati t'ia jepte Shoqata e Arkitektëve dhe e Urbanistëve.

Më vjen mirë që ekipi që e ka realizuar këtë projekt ka ide shumë progresive, që të ndërliken me mbrojtjen e asaj që konsiderohet publike, por natyrisht ky ekip nuk ka pasur mundësi të na jap të dhëna për uzurpimet marramendëse të pronës publike në kuadër të qytetit, prandaj edhe tretën hektarët në tërë qytetin dhe nuk dihet kush është uzurpatori. Ne kemi disa sinjale, sidomos për Kodrën e Diellit, ku parashiheshin dikur çerdhet, ndërsa tash janë ndërtuar pallate 15 katëshe etj.

Me këtë qasje të kësaj udhëheqjeje, shndërrimi i kryeqendrës tonë në një qendër vërtetë metropolitane, si qendër administrative, universitare, diplomatike, qendër e rinisë etj., vështirë se do të bëhet.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, e vlerësoi lart punën profesionale të kompanisë. Meqë ky projektplan do të shkoj në diskutim publik, e përkrahim, pastaj me vërejtjet dhe sugjerimet e qytetarëve të na kthehet për miratim.

Shefki Gashi e përshëndeti kompaninë për punën që e ka bërë për vizionin e dhënë në Planin zhvillimor urban të Prishtinës. Tani orientimet për zhvillimin e Prishtinës janë kryesisht të drejtuara kah pjesët e Gollakut dhe pjesët tjera që janë më pak të shfrytëzueshme për interesat bujqësore. Një vërejtje e kam në atë që thuhet se Prishtina është qytet i të rinjve. Prishtina është qytet i të gjithëve, për fat të mirë i të gjithë Kosovës, po pak për fat të keq i prishtinasve, sepse po vijnë njerëz me kulturë të ndryshme, që për Prishtinën janë pak të pa pranueshme, prandaj edhe ata duhet ta ruajnë kulturën dhe të adaptohen në kulturën që e donë Prishtina.

Naim Makolli tha se gjatë prezantimit të Planit zhvillimor urban vërejta se e gjithë infrastruktura, i gjithë koncentrimi i këtij zhvillimi është përkufizuar në 6 km

Diametër, sa ka sot Prishtina. Nëse parashohim një zhvillim urban të Prishtinës në këta 6 km, çfarëdo qoftë ai, duhet të kemi parasysh se për ta bërë një zhvillim tjetër duhet një rrënim, pastaj të ndërtohet diçka e re.

Në këtë plan të zhvillimit urban të Prishtinës nuk vërejta dy prurjet kryesore të qytetarëve të Prishtinës, siç është gryka e Gollakut, prej Makocit deri në Mramor dhe Prapashticë, dhe grykën tjetër të fshatrave të Llapit. Pra, e pash një planifikim shumë të paktë ose fare në atë pjesën ku duhet që konkretisht të orientohet zhvillimi urban i Prishtinës. Mirëpo unë e shoh shumë herë që edhe këto kompanitë që i bëjnë këto

projekte, projektuesit janë qytetarë të rinj të Prishtinës, thjeshtë nuk e njohin Prishtinën me fshatra dhe nuk e njohin infrastrukturën e Prishtinës ashtu siç duhet. Prandaj, nuk jam i kënaqur në tërësi, se në një të ardhme kur do të realizohej kjo, do të shihni se ka shumë mangësi për qytetarët e Prishtinës.

Prandaj, kisha propozuar që pjesën veriore dhe atë verilindore, ku Prishtina duhet të rritet, atje të shkojnë këto zhvillimet urbane që duhet të ndodhin, si në infrastrukturë.

Prof. dr. Isa Mustafa, meqë u hap çështja e Këshillit të ekspertëve për planifikim, tha se ne e kemi themeluar këtu në Kuvend Këshillin e ekspertëve për planifikim. Ata kanë filluar punën dhe kanë mbajtur disa takime. Kemi pasur moskuptimet e tyre lidhur me mënyrën e kompensimit të punës së Këshillit të ekspertëve dhe tani e kemi miratuar një rregullore në Këshillin e Drejtorëve lidhur me kompensimet, me kontrata mbi vepër, përmes së cilës jemi munduar të hapim mundësi që ata t'i kompensojmë mbi bazën ditore, ose mëditjeve ditore që ata i bëjnë si Këshill i ekspertëve. Në këtë fazën e debatit publik që do ta zhvillojmë lidhur me këto dy plane, ne do të mundohemi që të gjitha organizatat, institucionet që janë të specializuara për planifikim hapësinor, planifikim urban dhe planifikim zhvillimor, që ato t'i kyçim dhe të bëjmë debate të specializuara edhe me to.

Njëzëri u miratua Vendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor urban për periudhën 2013-2022.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ambasadës gjermane, arsyetimin e paraqiti Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.

Njëzëri u miratua Vendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ambasadës gjermane.

Pika e katërt

Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim SHPI - KFOR-it "Film City, arsyetimin për këtë propozim e paraqiti Agim Salihu.

Njëzëri u miratua Vendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim SHPI - KFOR-it "Film City".

Pika e pestë

Sa i përket Propozimvendimit për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik, Agim Salihu tha se me qëllim të realizimit të Planit rregullues të lagjes "Dodona", është kërkesë e Ministrisë së Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor që në procedurë të lëshimit të lejes së ndërtimit, të merren parasysh edhe dispozitat që kanë të bëjnë me largësinë e ndërtimit të objektit në objektin e kultit, në rastin konkret xhamisë, është propozuar që parcelat kadastrale të përfshira në pikën 2 të këtij Vendimi, të caktohen zonë me interes publik.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se kemi diskutuar lidhur me këtë pikë dhe e kemi vlerësuar pozitivisht veprimin në këtë rast, që parcela komunale të jetë hapësirë gjelbëruese, aq e nevojshme për këtë pjesën, por edhe për vet Prishtinën, ndaj dhe e çmojmë këtë veprim dhe gjithsesi do ta përkrahim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne si grup e përhëndesim kompromisin e Komunës me pronarët dhe vërtet është bërë një punë shumë e madhe që ajo pjesë afër xhamisë, të kthehet në zonë të gjelbërimit.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se kjo pjesë ka qenë e përfshirë në Planin rregullues "Dodona" dhe kur është e përfshirë në Ligjin e planifikimit hapësinor në një plan rregullues, atëherë pse ta shpallim interes publik, se duhet për ta ndryshuar atë. E dimë se në atë hapësirë kanë qenë të parapara ndërtime e tani është çështja se si do të bëhet kompensimi i këtyre pronarëve, pra a do të ketë hapësirë të mjaftueshme Komuna që ta bëjë ndërrimin prej asaj hapësirës gjelbëruese që e shndërron dhe pjesa tjetër që është e Komunës. Në këtë rast Komuna po iu përgjigjet pozitivisht personave që kanë një projekt për ndërtim, për arsye se ne po e marrim pjesën dhe po e bëjmë gjelbërim me interes publik dhe po ua lëmë mundësinë atyre që mos të bien ndesh me Ligjin për planifikim hapësinor dhe për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Prof. dr. Isa Mustafa tha se tash e dy vite po merremi me këtë problem. Ideja jonë ishte që ne të ndërtojmë aty një objekt, por më vonë problemi ka lindur nga ajo se Ligji për mbrojtjen e monumenteve të kulturës parasheh që këto objekte t'i largohen monumentit dhe është dashur të largohen pak nga xhamia. Për këtë Ministria e Kulturës e ka dhënë një zgjidhje, e cila nuk i ka detyruar shumë të largohen nga xhamia, por i ka detyruar që pjesët e kateve afër xhamisë të jenë më të ulëta. Shikuar nga ky aspekt, ne e pamë të arsyeshme që të tërhiqemi, mos të ndërtojmë fare si Komunë aty, por pjesën tonë që e kemi ta lirojmë dhe ta bëjmë hapësirë të gjelbër, një lloj parku për qytetarë, të cilin do ta zhvendosim në pjesën afër xhamisë, ndërkaq pronarët privatë t'i zhvendosim në të djathtë, që duke pasur parasysh këto objekte të trashëgimisë kulturore, veçmas Xhamia e Çarshisë, të kenë një pamje dhe një hapësirë më të mirë, por edhe qytetarët e Prishtinës ta kenë një park të tyre.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se çdo propozimvendim për caktimin e lokacioneve për qëllim të interesit publik e përkrahim.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne e përkrahim këtë vendim shumë të qëlluar.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se me këtë vendim kjo hapësirë e gjelbër i kthehet publikut, pra është një vendim jashtëzakonisht i mirë, por kalkulimet sigurisht nuk janë krejtësisht të qarta, për shkak se pronarit-ndërtuesit, praktikisht Komuna ia ofron njëfarë mundësie që shputën e ndërtimit ta ketë në proporcione krejtësisht 100%. Në rastin konkret, pra në rast se veprohet kështu, për sa hapësirë po dëmtohen banorët e atij blloku në ndërtim aty? Ne sigurisht që e përhëndesim çdo veprimtari që shkon në dobi të publikut të hapësirës së gjelbër. Në rastin konkret, aty një lulishte që do të mund ta kishte fare mirë edhe emrin e njërit prej njerëzve më të respektuar për këtë liri që e gëzojmë ne, por jo të krijohen kalkulime të kësaj natyre. Kjo është arsyeja që ne votojmë kundër këtij vendimi të kësaj forme.

Me dy vota kundër (Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu) dhe dy abstenime (Shemsi Veseli dhe Skënder Reçica), u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Agim Salihu.

Musli Meha, në emër të GP të LDK-së, tha se GP e ka shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës, duke u bazuar në arsyetimin e dhënë, që edhe ne e përkrahim në tërësi këtë propozim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, bëri pyetjen se ligjërisht a ka të drejtë që Komuna të marrë pronën pa kaluar afati pesë (5) vjeçar, ose a ka ndonjë nen, nëse i nevojitet, kuptohet mund të jetë një plan rregullues, i cili përfshinë një ndërtim ose të ndërtohen pishinat që kanë qenë të planifikuara aty. Nëse plotësohen kushtet për ndërtim a ka mundësi në afat më herët se pesë (5)vjet ta rikthen këtë pronë Komuna.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, shprehu mendimit që kjo parcelë të mos jepet në shfrytëzim në kohëzgjatje prej pesë (5)vitesh. Lidhur me këtë kërkoi që të shkurtohet afati që, për shkak të procedurës, të jetë të paktën brenda një (1) viti. Duhet të jemi shumë transparent në raport me opinionin, se tash kjo hapësirë është e uzurpuar, faktikisht është duke u shfrytëzuar në mënyrë jo ligjore.

Në anën tjetër, çfarë do të jetë natyra e autoparkimit, nëse duam për interesat e qytetarit, a do të jetë ku qytetarët kanë për ta paguar, apo do të jetë publik, apo privat. Do të ishte mirë që Komuna ta bëjë parking dhe ta shfrytëzojë për ndonjë destinacion tjetër edhe për interesin e qytetarëve. Tash po shihet se autoparkingu do të jetë privat, se po hyn në procedurë me qenë privat, por meqenëse ajo është në hapësirë publike, shtrohet problemi se çfarë interesi paska Komuna që parkingjet publike t'ia japë dikujt privat dhe të përfitojë në pronën publike, edhe ashtu Komunës së Prishtinës i mungojnë parkingjet. Me këtë po cungohet e drejta elementare e qytetarit të Komunës së Prishtinës për ta shfrytëzuar atë.

Duke pasur për bazë të gjitha këto gjëra, ne do të votojmë kundër.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se sipas asaj që ne kemi informata, kjo hapësirë ka qenë thjeshtë e uzurpuar, e që Komuna ka humbur vazhdimisht të mira materiale për shkak se i ka toleruar uzurpatorët të shfrytëzojnë pasurinë publike.

Tash, përmes këtij propozimvendimi, Komuna i rikthehet procedurës ligjore. Pse Komuna nuk e bënë vet parking publik, siç u shtrua këtu, apo ta shfrytëzojë për ndonjë destinacion tjetër edhe për interes të qytetarëve.

Ne kërkojmë që kontrata, respektivisht marrëveshjet që do të lidhim në procedurën e rregullt ligjore, të na vihen në dispozicion.

Besa Rafuna në emër të GP të LDD-së kërkoi nga zyrtari ligjor që t'i specifikoj në mënyrë ma te çartë arsyet e këtij propozimvendimi.

Mejreme Berisha në emër të GP te AAK-së tha se edhe ne jemi për shkurtimin e afatit për shfrytëzim të kësaj prone.

Naim Makolli shtroi pyetjen se a ka edhe qytetarë tjerë të Prishtinës, që për prona të caktuara të Kuvendit komunal të Prishtinës kanë bërë kërkesa dhe kanë zhvilluar projekte për zhvillime te bizneseve të ndryshme edhe nuk po shqyrtohen. Unë me sa

jam në dijëni ka plot, por nuk po shfrytëzohen, por po shkojnë vetëm pjesë, pjesë në mënyrë parçiale, vetëm për disa individ.

Tefik Mehmeti tha se nëse këtë pronë e japim në shfrytëzim për një (1) vit, jam i bindur se kemi me pasur kërkesa shumë të ulëta. Mendoj se duhet të mendohet në një afat me të gjatë, se edhe pesë (5) vite më duken se janë pak.

Me tri vota kundër (Sadri Ramabaja, Shemsi Veseli dhe Skender Reçica), miratohet Vendimi për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së pa luajtshme në shfrytëzim.

Pika e shtatë

Arsyetimin e Propozimvendimit për ndryshimin e Rregullores për të hyra për institucionet arsimore, në pika të shkurtra e paraqiti **Agim Salihu**.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin e Rregullores për të hyra për institucionet arsimore.

Pika e tetë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013, të pranishmit i informoi Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i cili tha se Kuvendi i Komunës ka përcaktuar mënyrën e pagesës dhe lartësinë e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013 si dhe beneficionet tjera për pagesën e këtyre lloj taksave, mirëpo nga ministria përkatëse duke u arsyetuar për disa gjëra nuk është dhënë pëlqimi që ky vendim të aplikohet.

Tefik Mehmeti tha se një zbritje e përgjithshme të taksave është në të mirën e qytetarëve, por sigurisht në dëm të komunës për arsye se ka të hyra më të vogla komuna. Pajtohem me këtë propozimvendim dhe me arsyetimin e dhënë dhe me një kërkesë që të fillon zbatimi i tij sa më shpejt.

Shemsi Veseli tha se edhe në pajtohemi me këtë propozimvendim, megjithatë unë jam që ta gjejmë një modus dhe t'ia dërgojmë Ministrisë, nëse ajo e miraton, thjesht që të jetë edhe e përkohshme.

Kryesuesi tha se në parim po e miratojmë me një kërkesë që ta dërgojmë menjëherë vendimin kështu, pra dhe ashtu jemi të obliguar ndaj Ministrisë së Pushtetit Lokal, dhe të kërkojmë nëse na mundësohet të aplikohet si avans deri në vendim përfundimtar.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013.

Pika e nëntë

Për Propozimvendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2013, arsyetimin për këtë propozim e paraqiti Agim Dibrani, u.d. i drejtorit të Drejtorisë për Financa dhe Pronë. Kryesuesi hapi diskutimin.

Luan Jusufi në emër të GP të LDK-së tha se gjatë shpenzimit të mjeteve buxhetore Komuna e Prishtinës gjatë këtyre viteve po përballet me vështirësi dhe probleme të ndryshme të natyrave të ndryshme.

Zakonisht problemet kryesore vijnë për shkak të kontesteve të ndryshme pronësore dhe kostos së lartë të shpronësimit të pronave nëpër të cilat duhet të kalojë apo të cilat janë të planifikuara për realizimin e projekteve komunale.

Me këtë rishikim të mjeteve do të ridestinohen nëpër kategoritë e ndryshme buxhetore sipas nevojave dhe prioriteteve të Komunës. Pjesa më e madhe e ridestinitimit të mjeteve bëhet për shkak të problemeve pronësore dhe procedurave të stërzgjatura të shpronësimit dhe kostos së lartë të tyre.

Gjithashtu kemi disa ridestinite të mjeteve monetare edhe të drejtoritë e ndryshme por vlera e tërësishme e këtyre projekteve të cilat ridestinohen është më e vogël se sa vlera e projekteve të cilat ridestinohen për shkak të problemeve pronësore dhe kostos së lartë të shpronësimit.

Ne si GP e votojmë këtë propozimvendim.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se, përveç asaj që për këtë propozimvendim ka fjalë miradije, mendoj se ka fjalë edhe për kritikë. Mendoj se ka mungesë të stafit profesional për vlerësimin, inicimin, implementimin, kontrollin dhe rivlerësimin e projektit të çfarëdo natyre që është.

Sipas këtij propozimi, nuk jepen çartë projektet e planifikuara dhe, në anën tjetër, mendoj se është një performancë e projekteve kapitale që kur bëhen planifikimet, bëhet sikur "ad-hoc". Mungojnë sqarimet më adekuate rreth shpronësimeve, e që ndërtimi i infrastrukturës nuk ka sqarime shumë të duhura, të mjaftueshme, në kuptimin e asaj se cilat janë arsyeshmëritë për financimin e projektit, shpronësim dhe ndërtim të infrastrukturës. Po ashtu, mungon edhe një sqarim i duhur rreth shpenzimeve për shërbime dhe mallra etj.

Milazim Vitija në emër të GP të AKR-së tha se na është premtuar para këtij Kuvendi se në mesin e pesë (5) rrugëve që kanë qenë në projekt për Marec ka qenë në projekt edhe asfaltimin e rrugës për Bullaj dhe tani ajo rrugë është hequr dhe në fund na është premtuar se me rishikimin e buxhetit do të hyjë edhe ajo, prandaj pyesim se çka është puna rreth asaj rruge.

Mejreme Berisha në emër të GP të AAK-së tha se duhet të kihet parasysh edhe sektori i arsimit që ka mungesë të kapaciteteve shkollore. Këtu e shoh se më së shumti i është dhënë rëndësi arsimit parashkollorë edhe kulturës në përgjithësi, prandaj pajtohem edhe me ato çështje që u ngritën, por megjithatë duhet të ecim përpara.

Feti Mehdiu në emër të GP të Partisë së drejtësisë tha se edhe ne pajtohemi që ky Vendim të shkojë me këto sugjerime që u përmendën, por sugjerimi im është që arsimit të mbetet si pikë e fundit për ta shqyrtuar, po duket sikur nuk është në rregull.

Mendimi ynë është që çështja e arsimit të jetë me prioritet, pra arsimit duhet të jetë i pari sepse edhe administrata publike edhe infrastruktura edhe të tjerat janë të lidhura dhe të mbështetura pikërisht te kuadrat e arsimit, të edukuara në frymën e kësaj shoqërie.

Sadri Ramabaja tha se kjo pikë e rendit të ditës do duhej të shqyrtohej ndoshta si e treta ose e dyta, për shkak të peshës që e ka.

Aktualisht në renditjen, siç u potencua te bartja, te rishikimi i buxhetit, arsimi është lënë krejtësisht në fund. T'ua kujtoj një fakt se në vendet e Evropës, si ne Gjermani, Angli, Itali etj., po rishikohet buxheti në dobi të ngritjes së cilësisë së arsimit, sidomos atij parauniversitar.

Me dy vota kundër (Sadri Ramabaja dhe Shemsi Veseli) u miratua Vendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013.

**Pika e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

Tefik Mehmeti paraqiti kërkesat për ndihmë për subvencionimin e ndërmarrjeve "Termokos" dhe "Pastrimi", me arsyetimin se këto dy ndërmarrje janë në gjendje shumë të rëndë. Lidhur me këtë tha se nëse nuk i ndihmojmë Termokosit në këtë sezon, do të ketë probleme rreth furnizimit me nxehtë, ndërsa për sezonin tjetër parashihet se do të lidhet me termocentralet "Kosova". Duhet t'i kemi parasysh këto, në mënyrë që sa më parë të ndihmohen këto dy ndërmarrje.

Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtim.

Kjo ka të bëjë me pyetjet që i kam bërë lidhur me mbledhjen e mbeturinave në fshatin Besi, brenda fshatit Besi e jo në magjistralen e fshatit Besi. Kompania "Pastrimi" nuk i mbledh mbeturinat në fshatin Besi.

Për eliminimin e qenve endacakë është folur që dy vite, andaj kur do të realizohet ky projekt?

Sa i përket nënkalimit apo vendkalimit, në bisedë zyrtare me drejtorin e kësaj drejtorie, më është thënë që, në bashkëpunim me Ministrinë, edhe Komuna ka kompetenca të investojë në atë projekt.

Edhe nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale lidhur me realizimin e projektit për rrjetin e kanalizimit në familjen Mexhuani dhe familjen Marrolli, është kthyer përgjigja se ky projekt nuk ka mundësi të realizohet derisa projektuesi ta fitojë tenderin.

Sadri Ramabaja ngriti dy çështje:

- Çështja e parë, ka të bëjë me mbikalimin te Ulpiana. Çfarë po ndodh me atë mbikalim, mos është ngjashëm me mbikalimin në fundin e lagjes Llapnasellë, atje ku nuk shfrytëzohet nga askush dhe janë hedhur paratë kot, a ka ndonjë shpjegim?

- Çështja e dytë, çështja e mirëmbajtjes së oborreve të ambulancave. Propozoj, si ide, që kjo çështje ose të zgjidhet përmes buxhetit, përmes angazhimit të punëtorëve teknikë, ose ta shqyrtojmë si Kuvend, t'ia japim kompanisë "Hortikultura" këtë kompetencë për mirëmbajtjen e oborreve të ambulancave.

Shefqet Sylejmani shtroi këto çështje:

1. Kur do të nisin punimet në realizimin e projektit, të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës ditë më parë, për ndërtimin e kanalizimit fekale dhe atmosferik në lagjen "Tophane", rrugët "Vushtrria" dhe "Meto Bajraktari", në gjatësi prej 150 m, i ndërtuar mbi 50 vite më herët, tani më i stërvjetëruar, i pa përbalueshëm për rritjen e

kësaj lagjeje dhe të tjerëve që gravitojnë në të. Tani ka mbi një muaj e gjysmë i mbyllur krejtësisht, dhe si pasojë kanalizimet po dalin në sipërfaqet e oborreve të shtëpive të lagjes, andaj dhe kërkohet intervenim i menjëhershëm - urgjent i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe operatorëve përkatës, dhe i Drejtorisë së Inspektionit për sanimin e gjendjes dhe parandalimin e ndonjë epidemie.

2. Në pronësi të kujt është hapësira - oborri dhe objektet në te, që gjenden mbrapa Bibliotekës së qytetit, përkatësisht ish-objekti i zhvillimit të aktiviteteve të SHKA-ve "Bajram Curri" dhe "Gerçek" dhe tani shfrytëzohet nga një shoqatë, e udhëhequr nga znj. Flora Brovina, në mënyrë që kjo të ketë dedikim edhe më të gjerë dhe vendosjen e disa shoqatave (si Shoqatës së zejtarëve, Shoqatës së grave (më specifike) - "Jeta - Vita", Shoqatës së artarëve dhe argjentarëve etj.)dhe institucioneve tjera të Prishtinës që janë shumë aktive, por pa kushte minimale materiale, teknike e hapësinore?

3. Pse nuk po jetësohet vendimi i Kuvendit të Komunës, i miratuar vite më parë dhe i premtuar disa herë nga drejtoria përkatëse për vijën e shkurtër të autobusit të trafikut urban nga Kodra e Diellit - rrugës së Dubrovnikut - Ministria e Arsimit - Plepat - Pishina e Gërmisë dhe anasjelltas, për ta lehtësuar udhëtimin e stërzgjatur të qytetarëve rreth tërë Prishtinës (prej mbi 1,30 orë), e që është me shumë dobi financiare për kompaninë dhe qytetarët, veçmas të moshuarit, ndërkaq në masë të madhe do ta çlironte komunikacionin dhe do të bënte më komod udhëtimin në vet autobusët e linjës nr. 4 ? Përndryshe, në trafikun urban problemet janë më se prezente që nga ato objektiva, që i kemi konstatuar më parë dhe për të cilat kemi ofruar ndihmën tonë financiare, por edhe të natyrës subjektive të padisiplinës, keq sjelljes, injorancës, mos përmbajtjes së rendit dhe vonesa, deri në një orë, bile edhe të ndërprerjes së punës sipas tekeve. Për këtë disa herë jam përpjekur ta kontaktojë drejtorin, por telefoni i tij nuk funksionon, ndërsa e kam informuar edhe aksionarin e kësaj ndërmarrje z. Rexhep Mustafa.

4. A ka leje, gjegjësisht a duhet të posedohet leje për vendosjen e kamerave nga ana e personave fizikë - individë dhe afaristë privatë, për vëzhgim në hapësirat - oborret e objekteve të banimit kolektiv, siç është rasti i një dyqanxhiu në Kompleksin banesor "Dielli", në lagjen "Kodra e Diellit" në Prishtinë, e që drejtpërdrejt i tangon banesat tona, pra të z. Shemsi Veseli, z. Naser Krasniqi, z. Shefqet Sylajmani, z. Osman Vitija dhe të tjerëve?

5. A do të fillojë nga puna sivjet në shtator, apo kur, çerdhja e fëmijëve në lagjen "Mati"? Kjo është pyetje e shumë familjarëve, të interesuar për planifikimin e vendosjes së fëmijëve të tyre në çerdhe.

Shemsi Veseli ngriti disa çështje:

Lidhur me këtë tha se edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kam ngritur çështjen e uzurpimeve dhe është premtuar se për këtë çështje Kuvendi do ta nxjerrë një vendim. Gjithashtu, Drejtoria e Pronës është zotuar se do ta japë një sqarim se a e kanë shfrytëzuar të njëjtit persona që e kanë marr dhe a ka ndonjë rast kur shfrytëzuesi ia ka dhënë dikujt tjetër në shfrytëzim, që në këtë rast do të ishte vepër penale. Mandej është hequr nga rendi i ditës, nuk ka kurrfarë sqarimi, andaj për hir të transparencës të më jepet sqarim, pasi që kam informacione se ata kanë marr tash kontrata, vendime. Nëse kjo ka ndodhur, atëherë është shkelje edhe më e rëndë në rast se iu ka vazhduar atyre vendimi.

Çështja e dytë, çështja e rrugës “B”, se ky projekt i rrugës ka devijuar dhe, si pasojë e kësaj, rrezikon rrëzimin e një shtëpie. Çfarë logjike ka në aspektin profesional me devijuar rruga, kur ka mundësi të shkohet drejt dhe të lidhet me lagjen “Mati”. Cili është ai organ që e ka bërë këtë devijim?

Çështja tjetër, ka të bëjë me një shqetësim, që parcela e ish-Trafikut Ndërrurban dhe parcela e Trafikut Urban në lagjen “Emshir”, është shndërruar në hekrari, çka është çudi gjendja e tanishme, dhe është shqetësimi i banorëve për gjendjen e tanishme të këtyre parcelave që janë shndërruar në depo mbeturinash. Nga këto materiale të rrezikshme janë të rrezikuar shumë familje. Kërkoj një përgjigje konkrete, çka është çështja? Pra, realisht është një avaz i moçëm që është duke vazhduar me Inspeksionin. Ne po e ngrijmë këtu çështjen, ndërsa atje po e lënë derisa po e kryejnë punën!

Kam ngritur shqetësimin edhe të qytetarëve të lagjes “Dardani”, që nga personat e pandërgjegjshëm është thyer shtylla që e ruan statikën e objektit dhe bodrumi është shndërruar në lokal. Për këtë çështje inspeksioni a ka shkuar në vendin e ngjarjes?

Shaip Hajrizi shtroi për diskutim disa pyetje dhe kërkesa.

Kërkesa e parë ishte nga banorët e disa fshatrave, të cilët thonë se qysh nga 22 qershori nuk kanë qasje të qarkullimit urban, në linjat Koliq - Prishtinë dhe anasjelltas, Ballaban - Prishtinë dhe Marec - Prishtinë. Arsyeja është se kombibusëve që kanë bartur personelin arsimorë janë ndalur, d.m.th pasi që shkollat janë mbyllur dhe tash qytetarët e asaj pjese kanë mbetur pa mundësi udhëtim me autobus. Kërkesa e tyre është që mundësisht me e kontraktuar ndonjë autobus gjatë këtyre 2-3 muajve të sezonit veror, sa shkollat janë të mbyllura.

Linja e premtuar dhe e aprovuar para disa viteve Kodra e Trimave - Gërmi, e që edhe qytetarët e kërkojnë vazhdimisht që të jetësohet kjo linjë. Edhe përkundër problemeve ekzistuese në Trafikun Urban, mendoj se ndoshta ekziston ndonjë formë tjetër për të filluar ajo linjë, pra me ndonjë person që ka autobus privat.

Kërkesa tjetër është kërkesa e tregtarëve në Tregun e Gjelbër, të cilët me çdo kusht kërkojnë që personat që shesin jashtë tregut, të hiqen sa më shpejt prej aty, sepse ata që janë brenda e paguajnë taksën dhe nuk kanë shitje të mjaftueshme, kurse këta që janë jashtë, nuk paguajnë taksë dhe kanë shitje.

Kërkesa tjetër është edhe çështja e tavolinave, e lirim të trotureve nëpër Prishtinë. Unë nuk e kam të qarte se a dalin inspektorët në terren, nëse dalin, atëherë pse nuk i heqin ato terasa, kur në masë të madhe e pengojnë lëvizjen e këmbësorëve, sidomos rrugës prej ABC-së deri te Policia.

Një përgjigje që kamë marrë nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, nuk është dhënë saktë. Nuk kam kërkuar me u shtruar rruga “Afrim Abazi”, se ajo është e shtruar, por kam kërkuar vazhdimin e rrugës nga rruga “Afrim Abazi” diku 500 m, ku ekziston edhe një fermë atje dhe personi që e ka fermën ka jashtëzakonisht problem në atë rrugë.

Ismajl Kosumi shtroi kërkesën për asfaltimin e një segmenti të rrugës, në gjatësi prej 500 m, në lagjen “Dodona”. Lidhur me këtë tha se edhe pse është shpallur tenderi për asfaltimin e saj, ajo prapë ka mbetur pa u asfaltuar. Kërkoj që kjo çështje të zgjidhet e mos të bëhet aq edhe banale.

Naim Makolli shtroi këto pyetje:

Pyetja e parë ka të bëjë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, i cili tha se kur është vënë gurthemeli për ndërtimin e QMF-së këtu në rr. “Bajram Bahtiri”, Komiteti për shëndetësi ka qenë i ftuar nga drejtori, kurse me rastin e

inaugurimit të objektit ne nuk jemi ftuar. Po ashtu jemi anashkaluar edhe për inaugurimin e objektit në Bardhosh, meqë jemi ftuar vetëm një orë para se të bëhet inaugurimi. Kërkojmë nga drejtori që, në bashkëpunim me kryetarin e Komitetit për Shëndetësi, ta kemi edhe një takim gjatë këtij mandati.

E dyta, është një kërkesë prej qytetarëve të rrugës “Xhevat Begolli”. Ata kanë kërkuar që mundësisht, në kuadër të rishikimit të buxhetit, të ndahen mjetet për ndërtimin e një rruge në gjatësi prej 150 m.

E treta, ka të bëjë rreth projektit për ndërtimin e rrethrotullimit afër spitalit, ku për shkak të punimeve, është ngadalësuar komunikacioni, andaj do të ishte mirë që kompania e cila e bën ndërtimin ta mirëmbajë atë rrugë.

Kërkoj nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale që mundësisht ato 20m rrugë, të shtrohen me asfalt dhe të shkarkohet ajo ngarkesë e cila po bëhet mu në mesin e ditës.

Kërkesa tjetër ka të bëjë me linjën e autobusit nr. 3. Kërkoj që mundësisht vija e kësaj linje të zgjatet deri te ish-Tregu i automjeteve, sepse tash për tash shkon në drejtim të hotelit “Princi i Arbrit”, mirëpo te “Princi i Arbrit” kemi edhe linjën 3A, kështu që ajo pjesë është e pa mbuluar.

Agim Gashi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se sa i përket mbeturinave nëpër fshatra, duhet të lidhet kontrata në mes Bashkësisë Lokale dhe kompanisë “Pastrimi”, është çështje procedurale, d.m.th. nëse në Barilevë kanë shprehur interesimin për grumbullimin e mbeturinave, Kompania është e gatshme, prandaj udhëhiqni procedurat.

Sa i përket qenve endacakë, do të mbetet ende problem në vete, sepse ne nuk kemi të drejtë të merremi me rastin e tyre dhe ligji na e ndalon. Deri tash jemi marr me trajtimin e tyre, tash në procedurë prokurimi është zhvillimi i projektit dhe pritet brenda pak ditësh të kontraktohet kompania që do ta fitojë trajtimin e qenve endacakë dhe do të vazhdojmë me të njëjtën metodë. Pra, nuk ka metodë tjetër, kemi me pas qenë endacakë edhe më tutje.

Sa i përket punës së kompanisë “Trafikut Urban”, është mirë që të kërkohet një informatë pak më detale nga aksionarët, përkatësisht edhe Bordi, nëse ka nevojë, për shkak se aty gjendja nuk ka ndryshuar, është ajo gjendje që ka qenë dhe ka me pas probleme deri te një zgjidhje tjetër e statusit të asaj kompanie.

Linjat mund të zgjaten në çoftë se operatorët bëjnë kërkesë dhe drejtoria ka të drejtë sipas rregullores, të zgjasë vijën e të njëjtës linjë e jo ta ndryshoj apo të hap të re, dhe ato që i kanë bërë kërkesat, i kanë marr përgjigjet. Edhe linja 3 mund ta shtrojë kërkesën ose dikush nga Bashkësia Lokale, do të mund të ja mundësojmë zgjatjen e linjës.

Shpresoj se këto ditë do të përgatitet tenderi për blerjen e autobusëve, nga mjetet që i ka vendosë ky Kuvend, dhe do të zbutet pak gjendja në trafikun urban.

Valbon Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, tha se sa i përket çështjes së mirëmbajtjes së oborreve të QMF-ve dhe ambulancave, tani për tani për mirëmbajtjen e tyre kujdeset shërbimi teknik, i cili është pjesë e stafit jo profesional në kuadër të QMF-së. Është e vërtet që ai staf që është, nuk arrin ta bëjë mirëmbajtjen më të mirë të mundshme. Deri më tani ne i kemi kushtuar rëndësi mirëmbajtjes së objekteve dhe punëtorët gjatë tërë kohës janë angazhuar në evitimin e avarive, prishjeve, dëmeve të mëdha nëpër sisteme të ndryshme, ndërkohë që këta janë përkujdes edhe për këtë mirëmbajtje.

Zakonisht na paraqiten më shumë probleme me kositjen e barit nëpër ambulancat që janë në fshatra dhe me mirëmbajtjen e pemëve ose të drunjtëve që janë të mbjellë, sepse këta punëtorë nuk janë shumë të kualifikuar për të bërë mirëmbajtje profesionale, por, megjithatë, me mundësitë dhe kapacitetet që i kanë kujdes nëpër këtë gjë.

Ajo që unë do të doja të vlerësoja dhe çmoja, në fakt vlerësimin e juaj që i quani shërbime profesionale, janë të shkëlqyera dhe vërtet janë të shkëlqyera në QMF-të, prandaj ky vlerësim që i bëhet nga ana e këshilltarëve apo nga ana e qytetarëve, na inkurajon neve që të vazhdojmë me punë në atë drejtim.

Sa i përket çështjes së ftesës për inaugurimin e QMF-së, nga ana e jonë ka qenë një lëshim i vogël dhe nuk është bërë me asnjë qëllim, ndërkohë që në Bardhosh nuk e kemi inauguruar ende dhe kur ta inaugurojmë gjithsesi se do të ftoheni.

Për mirëmbajtjen e oborreve të QMF-ve, **kryesuesi** propozoi që për mirëmbajtjen e tyre të kujdeset ndërmarrja "Hortikultura".

Ridvan Shahini, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, tha se janë dy projekte për ndërtimin e një mbikalimi dhe nënkalimi.

Projekti për mbikalim, që gjendet te spitali, ka përfunduar, por për projektin te lagjja "Arbëria", kemi pengesa gjyqësore nga ana e Hekurudhës, pra kjo është e kryer dhe mund të lëshohet brenda një jave.

Për mbikalimin te spitali, kryesisht është menduar për nxënësit që të mund të hipin përmes shkallëve. Po ashtu, në mes të tij është projektuar me qenë një lift, edhe përjashta një ekskavator, por nëse rastësisht e merr dikush atë në mirëmbajtje.

Sa i përket kanalizimit në lagjen "Tophane", me të vërtet ai kanalizim është shumë i vjetër, para 45 viteve është ndërtuar. Tani jemi në fazën e përgatitjes së tenderit dhe mendoj se në këtë vit ky projekt do të realizohet, që do të jetë për kanalizimin fekale dhe atmosferik.

Sa i përket rrugës "B", tash që është duke u punuar ajo, është punuar në tërësi dhe me të gjitha kuotat dhe koordinatat. Këtij projekti nuk iu ka bërë asnjë ndërrim, qoftë majtas apo djathtas, dhe se ky projekt është nën kontroll çdo herë.

Për vazhdimin e një segmenti të rrugës "Afrim Abazi", pjesa tjetër e vazhdimin të rrugës është pronë private, për atë edhe para tri viteve kur është punuar kanalizimi, është ndalur deri aty se më tutje ishte rrugë private. Nëse ajo shpronësohet, mundemi me vazhduar rrugën.

Ndërtimi i rrugës në lagjen "Dodona" është ndërprerë për shkak të bankrotimit të asaj ndërmarrje, e cila ka qenë duke e ndërtuar dhe tani është ndërprerë kontrata edhe prapë është ritenderuar nga Zyra e prokurimit.

Rruga "Xhevat Begolli" është ndërtuar para 4-5 viteve. Po është bërë para 4-5 viteve edhe dyshoj se edhe kjo rruga që është 150m në drejtim të përroit poshtë, mund të jetë private.

Mbledhja mbaroi në orën 14:00.

PROCESMBAJTËSI
Zijadin Gashi

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc.i dipl.